



Udhëzim për përgatitjen e Planit emergjent për aksion (për shoqata nacionale)

si dhe qasje në DREF dhe Planin emergjent si
mekanizma për sigurimin
e mjeteve financiare



Црвен крст на Република Македонија
Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë



International Federation
of Red Cross and Red Crescent Societies

Përmbajtja

Hyrje

Qëllimi i udhëzimit

Në cilën mënyrë është strukturuar udhëzimi?

Plan emergjent për aksion për shoqata nacionale

Mekanizma për financimin e operacioneve për përgjigje në situata emergjente të

Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe

Hapa për përgatitjen dhe azhurimin e planit emergjent për aksion si mjet operativ menaxhues

Faza 1: Para katastrofës – përgatitje për katastrofë apo krizë.

Faza 2: Menjëherë pas katastrofës

Faza 3: Dy deri tre javë pas katastrofës

Faza 4: Prej një muaji pas katastrofës e tutje

Faza 5: Muaji i fundit prej operacionit

Faza 6: Deri në tre muaj pas fundit të operacionit

Hyrje

Qëllimi i udhëzimit

Për kënd është?

Ky udhëzim është dedikuar si mjet referues për personat të cilët punojnë në planin e përgjigjes gjatë katastrofave në shoqatat nacionale të cilat sigurojnë përgjigje në katastrofa të cilat ndodhin menjëherë apo fillojnë ngadalë apo që punojnë në përgatitjen e krizës së pashmangshme. Gjithashtu ekziston edhe një udhëzim i tillë që shërben për përkrahjen e personelit të sekretariatit të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe që sigurojnë përkrahje për shoqatat nacionale në këtë proces.

Për çka shërben udhëzimi?

Ky udhëzim ka për qëllim të sigurojë përkrahjen e personave të cilët sigurojnë përgjigje në katastrofë të caktuar nëpërmjet:

- Përkrahjes në procesin e planifikimit, monitorimit, evaluimit dhe lajmërimit gjatë operacioneve për sigurimin e përkrahjes emergjente, duke kështu edhe përgatitjen dhe përdorimin e planit emergjent për aksion.
- Përgatitjes së kërkesës për sigurimin e mjeteve nga fondi për sigurimin e përkrahjes emergjente gjatë katastrofave (DREF), nëse ka nevojë, dhe menaxhim të operacioneve të financuara me DREF;
- Përgatitjes dhe menaxhimit të apelit emergjent, nëse ka nevojë.

Ky udhëzim i siguron aksionet kyçe të cilat duhet t'i zbatojnë shoqatat nacionale në faza të ndryshme të operacionit për sigurimin e ndihmës emergjente gjatë përgatitjes dhe përdorimit të aksionit emergjent për aksion. Këtu nënkuptojmë:

- Zbatimin e vlerësimit dhe analizës initiale.
- Planifikimin e operacionit efektiv për sigurimin e ndihmës emergjente, duke kështu edhe vendimin se a të aplikohet për sigurimin e mjeteve nga Fondi DREF apo udhëzim në apelin emergjent dhe hapat të cilat duhet të ndërmerren në cilat do nga këto dy raste;
- Menaxhimin e implementimit të operacionit për sigurimin e përgjigjes në situatë emergjente, duke kështu monitorim të vazhdueshëm të situatës dhe implementimin e operacionit;
- Revidimin dhe evaluimin e operacionit për përkrahje në situatën emergjente dhe sigurimin e raporteve adekuate.

Ky udhëzim nuk siguron udhëzime për menaxhuesit për katastrofa në bazë të prioriteteve të nevojshme, përmbajtje dhe vëllim të operacionit të tyre për përgjigje. Për ato vendimin e sjell menaxhuesi për katastrofa.

Ky udhëzim gjithashtu siguron lidhje me udhëzimin ekzistues për sigurimin e përgjigjes emergjente gjatë operacioneve për ndihmë gjatë katastrofave.

Përmbajtja e këtij udhëzimi do të revidohet në bazë të rregullt dhe do të përshtatet sipas nevojave. Së bashku me udhëzimet dhe mjetet për DREF dhe operacionet për sigurimin e konceptit të fleksibilitetit operativ për përkrahjen e implementimin e përgjigjes efektive gjatë zbatimit të operacioneve humanitare në rast të situatës emergjente.

Në cilën mënyrë është strukturuar udhëzimi?

Korniza kohore e paraqitur më poshtë i tregon fazat e ndryshme kronologjike të operacionit për përgjigje në situata emergjente. Ky dokument i përcjellë këto faza kronologjike dhe siguron hap pas hapi dhe lajmërim për apel emergjent për aksion. Në bazë të aktiviteteve kyçe të cilat ndodhin në secilën fazë, siguron listën e gjërave të cilat duhet të kontrollohen nga ana e personit përgjegjës në bazë të apelit emergjent për aksion.

Apeli emergjent për aksion duhet të revidohet dhe përgatitet në mënyrë progresive në secilën fazë, në bazë të vlerësimit të vazhdueshëm, analizë dhe monitorim.

Nëse shoqatës nacionale i nevojitet përkrahje financiare nga Federata ndërkombëtare për realizimin e operacionit, dokumenti gjithashtu siguron hap pas hapi kahje për kërkim të përkrahjes financiare DREF, revidim të planit emergjent për aksion, buxhet dhe / apo kornizë kohore për operacion financiar DREF si dhe lajmërim në bazë të përdorimit të fondeve DREF, sipas nevojave individualisht për secilën fazë.

Nëse operacioni obligon ndërmarrjen e përgjigjes prej një vëllimi më të madh dokumenti siguron kahje në bazë të hapave të nevojshme të cilat duhet të përdoren për përgatitje, përcjellje dhe lajmërim në bazë të planit emergjent për aksion për operacion të përfshirë me apelin emergjent.

Korniza operative kohore – Faza kronologjike

Situatë emergjente nga katastrofa		ÇKA NDODH?			
		Implementim	Vlerësim & Monitorim	Planifikim	Revidim Evaluim
Përgatitshmëri për përgjigje	Para katastrofës (3 javë deri në 1 ditë para katastrofës)	Përgatitshmëri për situatë emergjente	Monitorim të situatës	Plan fillestar emergjent për aksion	
	Menjëherë pas katastrofës (1 deri në 2 javë pas katastrofës)	Përgjigje emergjente	Vlerësim fillestar		
Shpëtim dhe mbajtje në jetë	2 deri në 4 javë pas katastrofës	Përgjigje emergjente	Vlerësim të mëtutjeshëm	Revidim të planit emergjent për aksion përderisa ka nevojë	
	Prej një muaji e mëtej	Implementimi i aktiviteteve të planifikuara dhe nëse ka nevojë revizion të aktiviteteve nga operative	Monitorim të vazhdueshëm të situatës dhe operacionit		
Kthimi i kushteve të sigurta për jetesë	Muaji i fundit i operacionit			Përgjigje emergjente	
	1 – 3 muaj pas përfundimit të operacionit				

Plan emergjent për aksion për shoqatat nacionale

Çka është plani emergjent për aksion?

Plani emergjent për aksion është mjet kryesor operativ dhe menaxhues që rekomandohet për të gjitha llojet e operacioneve emergjente. Jo vetëm që siguron sigurim efektiv në përgjigjen emergjente, por gjithashtu paraqet bazë për mobilizimin e resurseve për aktivitete për sigurimin e përgjigjes së katastrofës. Plani gjithashtu ndihmon në planifikimin, sigurimin e shërbimeve, monitorimin, evaluimin dhe lajmërimin lidhur me operacionin. Plani emergjent për aksion bazohet në analizën e ndikimit të katastrofës, dëmin e shkaktuar, nevojat e popullatës së goditur dhe kapacitetet e vepruesve të ndryshëm që ndihmojnë në kënaqjen e nevojave prioritare.

Në të duhet të shikohet si në dokument të gjallë i cili vazhdimisht azhurohet me sigurimin e informacioneve të reja apo me ndryshimin e situatës. Ai e përcjell strukturën e kornizës logjike, me qëllime, aktivitete dhe kontribute të definuara. Si praktikë e mirë duhet të përmbajë edhe analizë që çon në definimin e aktiviteteve të planifikuara.

Pothajse gjatë gjitha operacioneve për ndihmë emergjente do të ketë përgjigje emergjente për shpëtimin e jetës para se të ndodhë çfarëdo lloj vlerësimi formal. Ky aksion emergjent shpesh herë bazohet në informacione të kufizuara të cilat janë të kapshme në bazë të ndikimit të katastrofës në ditët e para, dhe është e varur nga planet emergjente të realizuara nga shoqata nacionale në koordinim me të tjera në bazë të skenarit të caktuar për katastrofë.

Në të njëjtën kohë, gjatë zbatimit të aktiviteteve për shpëtimin e jetës, do të fillojë vlerësimi i dëmeve dhe nevojat si bazë për planifikim të mëtutjeshëm të pjesës tjetër të operacionit për sigurimin e përgjigjes në katastrofa.

Pas ndodhjes së katastrofës sa më shpejtë që mundet duhet të përgatitet plan fillestar emergjent për aksion që të mundet aktivitetet të zbatohen në mënyrë të strukturuar dhe të përcillet realizimi i tyre në pajtueshmëri me planin fillestar. Versioni fillestar mund të jetë dokument i lehtë në fillim. Pasi të sigurohen më shumë informacione në bazë të dëmit dhe nevojave si dhe kapacitetet e vepruesve të tjerë të cilët sigurojnë përgjigje, duhet të përgatitet plan më detal për aksion për pjesën e mëtutjeshme të operacionit.

Kjo praktikë e mirë e vlerësimit të vazhdueshëm dhe verzioni i planit për aksion është e patjetërsueshme kur të përdorim mekanizma globale për përgjigje gjatë katastrofave të Federatës ndërkombëtare, duke kyçur edhe mekanizmat për DREF dhe apel emergjent.

Varësisht nga vëllimi i përgjigjes, operacioni mund të realizohet në mënyrë të pavarur me resurset e shoqatës nacionale dhe fondet të cilat janë të kapshme në shtet. Nëse ato nuk mjaftojnë, dhe ka nevojë për Fond DREF, duhet të përgatitet plan emergjent për aksion që do të paraqesë bazë për kërkim, përcjellje dhe lajmërim për operacionin DREF. Ngajshëm me këtë, nëse ka nevojë të dërgohet

apel emergjent, plani emergjent për aksion do ta sigurojë bazën për planifikim, përcjellje dhe lajmërim për operacionin.

Kush është përgjegjës për planin emergjent për aksion?

Menaxhuesi i operacionit në shoqatën nacionale i cili do ta udhëheqë implementimin e operacionit, duhet të jetë përgjegjës për përgatitje dhe revidim të planit emergjent për aksion. Delegati relevant për menaxhim me katastrofa i Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe mund të sigurojë përkrahje në këtë proces. Në rast të katastrofës së madhe, ku Federata ndërkombëtare implementon operacion të madh, përgjegjësia dhe përgatitja e planit fillestar për aksion do t'i jepet ekipit ç[r koordinim dhe vlerësim në teren (ekipi fakt).

Mekanizma për finansimin e operacioneve për përgjigje në situata emergjente të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe

Fondi për sigurimin e ndihmës emergjente gjatë katastrofave (DREF)

Çka është DREF?

DREF është Fond i cili përdoret për përkrahjen e përgjigjes emergjente të shoqatave nacionale në katastrofa të nxitura nga njeriu dhe katastrofat natyrore.

Kush siguron mjete financiare për DREF?

Të hollat sigurohen nga donacione nëpërmjet apelit vjetor të sekretariatit të Federatës ndërkombëtare që menaxhon me fondin.

Për çka mund t'i shfrytëzojë shoqata nacionale të hollat nga DREF?

Mjetet financiare mund të përdoren për mbulimin e shpenzimeve për sigurimin e përgjigjes emergjente në katastrofa bnatyrore dhe të shkaktuara nga vet njeriu, kriza apo situata emergjente shëndetësore të cilat sapo kanë ndodhur apo mund të ndodhin.

Alokacionet DREF mund të përdoren si:

- Dotacion për financimin e aktiviteteve për përgjigje dhe përgatitshmëri gjatë situatës emergjente për katastrofa të pashmangshme apo kriza.
- Dotacioni për finansimin e përgjigjes në situata më të vogla emergjente të ashtuquajtura operacione DREF.
- Huamarrje për mjete financiare fillestare për operacione për të cilat përgatitet apel emergjent.

Kur mund të dorëzohet kërkesë shoqata nacionale për përkrahje nga Fondi DREF?

- Shoqata nacionale mund të kërkojë përkrahje nga Fondi DREF nëse nuk ka mjaft mjete financiare apo qasje në fonde për kënaqjen e nevojave emergjente të popullatës së goditur nga katastrofa.
- Kërkesa duhet të përgatitet sa më shpejtë që mundet që të sigurohet aksioni emergjent dhe në kohë. Shoqata nacionale duhet të kontaktojë me përfaqësuesin e Federatës ndërkombëtare sa më shpejtë që mundet me qëllim që të caktohet përkrahje e mundshme nga fondi.

Sa para mund të kërkojë shoqata nacionale nga Fondi DREF?

Shuma për alokacion do të varet nga vëllimi i përgjigjes – numri i njerëzve të cilëve duhet t'ju jepet ndihmë dhe shpenzimet për sigurimin e përkrahjes së nevojshme – deri në kufi të caktuar. Mbi kufijtë e caktuara Federata ndërkombëtare mund të sjellë vendim se nevojat janë shumë më të mëdha dhe se duhet të dërgohet apel emergjent.

Si dorëzohet kërkesë shoqata nacionale për DREF?

Që të kërkohet alokacion DREF, shoqata nacionale duhet ta kontaktojë zyrën e Federatës ndërkombëtare në vend, rajon apo zyrë në zona sa më shpejtë që mundet dhe të sigurojë informacione për situatën, plan për aksion i cili e sqaron planin për përgjigje si dhe buxhet adekuat. (Shikoni udhëzimin për përgatitjen e planit emergjent për aksion dhe kërkim të DREF të paraqitura më poshtë).

A duhet t'i kthejë shoqata nacionale të hollat nga alokacioni DREF?

- Nëse ndihma e planifikuar është e kufizuar dhe mund të sigurohet në periudhë të shkurtë kohore (3-4 muaj), shoqata nacionale duhet të kërkojë dotacion për përkrahjen e operacionit të vet. Vetëm të hollat e paharxhuara duhet të kthehen në Fondin DREF në fund të operacionit.
- Nëse nevojat janë të mëdha, duhet të dërgohet apel ndërkombëtar. Në këtë rast alokacioni DREF do të llogaritet për huazim për financim fillestar. Ky huazim bëhet si avans për kontributet të cilat ndahen në apel dhe kthehet prapë në Fondin DREF pasi të merren mjete të mjaftueshme në apel. (Shikoni pjesën për “Çka është apeli emergjent?”).

Çka duhet të bëjë shoqata nacionale nëse merr mjete financiare nga Fondi DREF?

Për dotacion, shoqata nacionale patjetër duhet:

- Ta respektojë buxhetin DREF të miratuar dhe t'i mos i përdorë mjetet financiare për aktivitete tjera vetëm nëse zyrtarisht nuk revidohet plani për aksion dhe për buxhetin dhe të merret leje për revizion nga federata ndërkombëtare.

- Ta zbatojë operacionin në korniza të kornizës kohore të caktuar dhe të kërkojë vazhdimin e kornizës kohore nëse është e patjetërsueshme.
- Të përgatisë raport përfundimtar narativ dhe financiar deri tek Federata ndërkombëtare në bazë të shfrytëzimit të mjeteve financiare për realizimin e operacionit të planifikuar.
- Të sigurojë ripërtirje operative të informacioneve deri te Federata ndërkombëtare që të dorëzojë raport në bazë të revizionit të caktuar në planin për aksion apo vazhdim të kornizës kohore për implementimin e operacioneve.

Për huamarrje shoqata nacionale patjetër duhet:

- Ta kompensojë huamarrjen në Fondin DREF kur të merren 150% nga shuma e huamarrjes nëpërmjet mjeteve financiare të pacaktuara në apelin emergjent.
- Të kompensohet huamarrja në Fondin DREF kur 150% e shumës së huamarrjes është marur si mjete të pacaktuara për apelin emergjent.

Mekanizën – apel emergjent

Çka është apeli emergjent?

Sekretariati i Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe kërkon përkrahje (mjete financiare vullnetare) për operacionet e veta për përgjigje emergjente gjatë katastrofave nëpërmjet apeleve emergjente të cilat dërgohen në rast të katastrofave të cilat ndodhin menjëherë apo që kanë fillim më të ngadaltë.

Përgjigja emergjente është mjet ndërkombëtar për marketing dhe pozicionim për promovimin e operacionit para partnerëve / donatorëve dhe vepruesve të jashtëm / opinionit, me qëllim të akumulohen mjete financiare. Drejtohet nga ana e Sekretariatit të Federatës ndërkombëtare në emër dhe kërkesë të shoqatës nacionale të caktuar. Apeli emergjent ka për qëllim të tregojë se si organizata ka qëllim të zbatojë operacion të planifikuar për të përkrahur shoqatë nacionale të caktuar (apo shoqata nacionale) për të siguruar ndihmë për grup specifik të grupeve të njerëzve të goditur nga katastrofa.

Kur mund të kërkojë shoqata nacionale të drejtohet apel emergjent?

- Kur nevojat humanitare e tejkalojnë kapacitetin e shoqatës nacionale të goditur.
- Kur alokacioni DREF nuk është i mjaftueshëm të mbulohen nevojat e parapara dhe kur ka potencial për marjen e mjeteve financiare nëpërmjet apelit emergjent.
- Kërkesë për udhëzimin e apelit emergjent duhet të bëhet sa më shpejtë që mundet të mundësohet aksion emergjent dhe në kohë; duhet të realizohet kontakt me përfaqësuesin e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe

Gjysmëhënës së kuqe sa më shpejtë që mundet që të bëhet marrëveshje për aksion të koordinuar.

Për çka mund të shfrytëzohen mjetet e marura nga apeli emergjent?

Apelet emergjente kanë për qëllim t'i mbulojnë shpenzimet lidhur me sigurimin e përgjigjes emergjente dhe rimëkëmbje nga katastrofa natyrore apo katastrofë e shkaktuar nga njeriu apo situata shëndetësore emergjente për përgjigje në nevoja humanitare të rëndësishme të popullatës së goditur.

Sa mund të jetë buxheti i apelit emergjent?

Buxheti i apelit emergjent varet nga vëllimi dhe madhësia e katastrofës, dhe përgjigjja që nevojitet në bazë të numrit të njerëzve të cilët duhet të ndihmohen, lloji i ndihmës, dhe shpenzimet shoqëruese për sigurimin e ndihmës.

Si e bën kërkesën shoqata nacionale për të dërguar apel emergjent?

Që të kërkohet dërgim i apelit emergjent shoqata nacionale duhet të bie në kontakt me përfaqësuesin e Sekretariatit të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në vendin, rajonin apo zyrën e vet në atë zonë, sa më shpejtë që mundet dhe të sigurojë informacione për situatën dhe të përgatisë informacione për situatën dhe të përgatisë plan emergjent për aksion në të cilin është paraqitur plani për përgjigje të shoqatës nacionale dhe buxheti për implementimin e këtij plani.

Pastaj, Sekretariati i Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe do ta përpilojë apelin emergjent që paraqet dokument me informacione të shumuara që janë të përmbajtura në planin emergjent për aksion, dhe ky dokument shpallet në veb faqen e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Sekretariati i Federatës ndërkombëtare do të sigurojë përkrahje për shoqatën nacionale në bazë të marketingut dhe aktiviteteve për mobilizimin e resurseve. *(Shikoni udhëzimin për përgatitjen e planit emergjent për aksion dhe kërkim për drejtimin e apelit emergjent pëa aksion më poshtë).*

Cila është korniza kohore operative e cila mund të përfshihet me apelin emergjent?

Korniza kohore operative e përfshirë me apelin emergjent varet nga madhësia dhe serioziteti i katastrofës, por në numër më të madh të rasteve ajo nuk duhet të jetë më gjatë se 1 vjet.

Çka do të ndodhë me alokacionin DREF kur do të dërgohet apeli emergjent?

Nëse nevojat janë më të mëdha dhe sjellet vendim të dërgohet apel emergjent, alokacioni DREF do të llogaritet si huazim për sigurim fillestar të mjeteve financiare. Huamarrja bëhet në formë të avansit për kontributet për apel i cili

pastaj patjetër duhet të paguhet prapë në Fondin DREF kur të sigurohen mjetet financiare të mjaftueshme nëpërmjet apelit (shiko pjesën “Çka është DREF?”).

Çka duhet të bëjë shoqata nacionale pasi të dërgohet apeli emergjent?

Shoqata nacionale patjetër duhet:

- Ta respektojë planin e miratuar për aksion / buxhetin e apelit dhe t'i mos i përdorë mjetet financiare për aktivitete tjera, vetëm nëse shoqata nacionale zyrtarisht nuk e revidon planin për aksion dhe buxhetin dhe të kërkojë leje për revizion para Sekretariatit të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.
- Të zbatojë operacion në kuadër të qëllimeve të kontratuara dhe kornizës kohore, dhe ta vëzhgojë implementimin.
- Të punojë me kolegët e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe që të sigurohen raporte në kohë dhe të sakta (duke kyçur edhe revizionin në planin për aksion i cili rezulton me revizionin buxhetor apo vazhdimin e kornizës kohore). Lajmërimi gjithashtu nënkupton përgatitjen e raportit final narativ dhe financiar për përdorimin e mjeteve financiare gjatë implementimit të planit për aksion.

Hapa për përgatitjen dhe azhurimin e planit emergjent për aksion si mjet operativ për menaxhim

Faza 1: para katastrofës – përgatitje për katastrofë të drejtpërdrejtë apo krizë.

Katastrofa e drejtpërdrejtë apo kriza është kërcënim apo rrezik që nuk mund të planifikohet paraprakisht e pothuajse sigurisht do ta rrezikon jetën e njerëzve dhe ka gjasa të ndodhë në të ardhmen e afërt (për shembull cikloni, rritja e shpejtë e nivelit të lumenjëve, aktivitet i rritur vullkanik, paraqitja e epidemisë, konflikte qytetare lidhur me zgjedhje). Këtu nuk kyçim ngjarje të cilat janë sezonale dhe përsëri paraqiten, siç janë vërshimet sezonale, për të cilat mundësisht që sa më parë të përgatitemi apo të planifikojmë përgjigje.


Nëse përgatiteni për katastrofë të drejtpërdrejtë, fokusi juaj kryesor do të jetë në vlerësimin e ndikimit që mund të del nga katastrofa në vendin tuaj dhe ndikimi i popullatës për të cilën ekziston mundësi se mund të jetë e goditur. Qëllimi është të kufizohet ndikimi nëpërmjet aktiviteteve për përgatitshmëri gjatë katastrofave. Këto aktivitete me siguri do të kanë të bëjnë me përvojat paraprake për katastrofa sezonale dhe planifikim të situatave emergjente që bëhet nga ana e shoqatës nacionale dhe vepruesve të tjerë në këtë mjedis.

Implementimi i aktiviteteve për përgatitshmëri dhe përgjigje gjatë situatave emergjente mund të jenë të përbëra prej:

- Paralajmërimin të hershëm
- Evakuimit të kategorive të rrezikuara të popullatës
- Aktivizimit të planit për veprim emergjent
- Përgatitjes së strehimoreve për situata emergjente
- Mobilizimit të të punësuarve dhe vullnetarëve
- Zbatimit të trajnimeve për freskimin e diturive të vullnetarëve
- Furnizimit dhe pozicionimit të ndihmës humanitare (në mallëra, dhe mjete financiare)
- Përgatitjes së planit emergjent inicial për aksion

Hapa kyçe për përgatitjen e planit emergjent për aksion

Hapat kryesore për zbatimin e vlerësimit, analizës dhe planifikimit fillestar do të jenë:



Këto 5 hapa ju çojnë kah sigurimi i informacioneve të patjetërsueshme për planin inicial emergjent për aksion, që shërben si bazë për menaxhimin e operacionit. Ky plan emergjent për aksion gjithashtu do t'ju mundësojë që partnerët e juaj të jenë të njoftuar me aktivitetet tuaja të planifikuara dhe mobilizimi i resurseve, nëse ka nevojë.

Më poshtë do të gjeni listën e kontrollimit që jep më shumë detaje në bazë të secilit prej këtyre 5 hapave.

Kur nuk ka informacione të kapshme të japin përgjigje në njërin prej pyetjeve të parashtruara në listën për kontrollim, rekomandohet të shihet se sa është i rëndësishëm ky aktivitet për të filluar aktivitetet për përgjigje gjatë katastrofave.

Lista për kontrollim 1 – 5 hapa për aksion për katastrofë të drejtpërdrejtë apo krizë.

Hapi 1: Vlerësimi i ndikimeve të mundshme dhe dëme nga katastrofa	
<p>Pyetje të cilat duhet të merren parasysh</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çka mund të ndodhë? Kur? • Cilat pjesë me siguri do të goditen? • Sa njerëz mund të jenë të goditur nga katastrofa? • Çfarë ndikimi pritet se do të ketë rreziku në vendin tuaj? Çfarë dëmi do të shkaktojë dhe çfarë pasoja të mundshme mund të dalin? 	<p>Aktivitetet për përkrahje</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitoring dhe evolucion i situatës • Vëzhgimi i tregut dhe çmimeve • Përcjellja e informacioneve nga vepruesit tjerë
Humbja e jetës	Shpërmgultja e popullatës. Anëtarë të ndarë të familjeve të ndara
Lëndim	Humbja apo dëmi i ndërtesave dhe infrastrukturës publike
Humbja e qasjes në ushqim dhe ujë	Shkatërrim / çrregullim i shërbimeve esenciale
Humbja e bagëtisë	Humbja apo dëmtimi i tregjeve lokale
Humbja apo dëmtimi i kullosave dhe mjedisit jetësor	Rrezik i rritur nga sëmundjet dhe implekimet tjera shëndetësore
Shkatërrim apo dëme të shtëpive	
<ul style="list-style-type: none"> • Si mundet situata të zhvillohet në javët apo muajt vijues? A ka efekte sekondare që priten siç janë traumat vijuese, lëvizja e popullatës apo rreziku nga paraqitja e sëmundjeve të cilat barten me ujin? 	

Hapi 2: Vlerësimi i nevojave potenciale dhe situatave të mjeruara	
<p>Pyetje të cilat duhet të merren parasysh</p> <ul style="list-style-type: none"> • Cilat janë kërcënimet emergjente për mirëqenien e njerëzve? • Cilat janë nevojat emergjente? • Cila popullatë është më e mjeruar / më e goditur? Pse kjo popullatë është më e mjeruar se sa 	<p>Aktivitete për përkrahje</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konsultime me organizatat komunale të Kryqit të kuq, pushtetet lokale dhe vepruesit tjerë.

<p>popullata tjetër (shembull: moshë, gjinia, hendikepi, prindërit që kujdesen vetë, grupi minor etj.)?</p> <ul style="list-style-type: none"> • A ka nevojë për aksion emergjent? 	
---	--

Hapi 3: Analiza e kapaciteteve

Pyetje të cilat duhet të merren parasysh	Aktivitete për përkrahje
<ul style="list-style-type: none"> • Si është kapaciteti për përgjigje e shoqatës nacionale? <ul style="list-style-type: none"> ○ A keni organizata komunale të Kryqit të kuq / vullnetarë në fushat për të cilat ekziston mundësi se do të goditen? A jeni në gjendje të kontaktoni me ato? Çfarë kapacitete posedojnë ato? Çfarë hapa kanë ndërmarrë ata? ○ A keni plan për aksion emergjent për këtë situatë emergjente? Nëse keni, a e keni aktivizuar ? ○ A keni rezerva të mallërave për përdorim në rast të përgatitshmërisë për katastrofën? <ul style="list-style-type: none"> ▪ Po – A janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat emergjente? ▪ Po – A i keni pozicionuar në pjesët të cilat janë në afërsi të lokacionit të mundshëm ku do të ndodhë katastrofa. ▪ Jo – Ku mund të sigurohen sasi të nevojshme për ndihmë (në natyrë / mjete financiare)? Në nivel lokal apo nga rezervat e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe? • Çka punojnë partnerët tjerë apo çka planifikojnë të punojnë (shiko, mbrojtje civile / ministria e mbrojtjes, kombet e bashkuara, organizata joqeveritare, shoqata tjera nacionale, Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq etj.)? • A ka realizuar mekanizma tjera ndërkombëtare apo nacionale për koordinim? Nëse ka çfarë lloji të mekanizmave jano ato? Çfarë roli keni ju në kuadër të këtyre mekanizmave? • A janë të goditura këto bashkësi nga katastrofa të ngjajshme apo të ndryshme në të kaluarën e afërt? Si është kapaciteti i tyre që të 	<ul style="list-style-type: none"> • Ndarja e informacioneve dhe koordinim me partnerë mes cilave KNKK dhe partnerë tjerë të lëvizjes. • Postimi i raportit në sistemin informativ për menaxhim me katastrofa.

<p>ballafaqohen me kërcënimet me të cilat ballafaqohen?</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çfarë mangësi ekzistojnë në përkrahjen e planifikuar që mund të jenë të adresuara nga ana juaj? • Çfarë kapacitete teknike / ekspertizë / përvojë keni në këtë lloj të përgjigjes? • A ka diçka që mund t'ju ndalojë në sigurimin e përgjigjes adekuate? Çka mund të bëni në bazë të kësaj? 		
Vështirësi të vlerësohen pjesë të caktuara	Vullnetarët nuk kanë pajisje për mbrojtje	
Komunikime të kufizuara	Probleme sigurie	
Mos ekzistimi i organizatës komunale të Kryqit të kuq në pjesët të cilat mund të goditen nga katastrofa	Mosekzistimi i rezervave emergjente	
Mosekzistimi i kapacitetit që të përgjigjet menjëherë	Mosekzistimi i personave profesional në sektorët specifik teknik	
Mosekzistimi i vullnetarëve teknik		
<p>Hapi 4: Definimi i qëllimeve dhe aktiviteteve të cilat duhet të zbatohen</p>		
<p>Pyetje të cilat duhet të merren parasysh</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çfarë nevoja planifikoni të plotësoni? • Cilat aktivitete nevojiten të zbatohen para / gjatë dhe pas katastrofës? • Sa do të zgjasin aktivitetet? • Cilët njerëz do t'i ndihmoni me aktivitetet tuaja? Sa dhe ku? • Për çka këta njerëz janë më të mjeruar nga të tjerët (shembull: moshë, gjinia, hendikepi, prindërit që kujdesen vetë, grupet minore etj.)? • A jeni të fokusuar në pjesë të caktuar gjeografike apo grup njerëzish? Pse? 	<p>Aktivitete për përkrahje</p> <ul style="list-style-type: none"> • Konsultime me organizatat komunale të Kryqit të kuq, pushtetet lokale dhe vepruesit tjerë 	

Hapi 5: Përgatitja e buxhetit dhe definimi i resurseve të nevojshme

Pyetje të cilat duhet të merren parasysh

- Cilat resurse ju nevojiten për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara në periudhën para dhe në fazën fillestare të katastrofës apo krizës (shembull: njerëz, resurse financiare, përkrahje teknike, logjistikë / transport etj.)?

Pasi të identifikohen resurset e nevojshme për përgjigje në katastrofën e drejtpërdrejtë, hapi në vijim do të jetë të sjellët vendim se a i keni të gjitha resurset e nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të nevojshme apo a do të ketë shoqata juaj nacionale nevojë për ndihmë të jashtme.

Nëse nuk keni qasje në resurset e nevojshme të cilat5 ju duhen për implementimin e përgjigjes emergjente (resurse tuaja personale apo qasje në mjetet e patjetërsueshme të mjeteve financiare nga partnerë në vendin tuaj apo nëpërmjet fushatës nacionale për sigurimin e mjeteve)? Lista e cila është paraqitur më poshtë do t'ju ndihmojë se si të kërkon ndihmë nga Fondi DREF. Për kërkimin e ndihmës DREF shihni kahjet e paraqitura më poshtë në listë për kontrollim A.

Nëse nevojat janë më të mëdha dhe alokacioni DREF nuk është i mjaftueshëm për të mbuluar operacionin e përgjithshëm për përgjigje në katastrofa, mund të dërgohet apel emergjent, ndërsa mjetet nga Fondi DREF mund të përdoren si mjete fillestare, e pastaj plani të revidohet në periudhë prej 2 deri 4 javë kur të keni më shumë informacione në dispozicion në bazë të dëmit dhe nevojave të cilat dalin nga katastrofa.

Në këtë rast alokacioni DREF do të llogaritet si huazim për financim fillestar që i mundëson shoqatës nacionale ta fillojë operacionin për përgjigje emergjente. Për dërgimin e apelit emergjent shikoni udhëzimin më poshtë në listë për kontrollë B.

Nëse mundeni për momentin ta siguron përgjigjen adekuate në katastrofë me resurset tuaja personale, mund të kërkon ndihmë financiare nga Fondi DREF apo nëpërmjet apelit emergjent në fazën e mëvonshme që t'i kompenzoni rezervat tuaja apo për kompensimin e shpenzimeve të cilat i keni bërë për përgjigjen emergjente. Kjo duhet të bëhet menjëherë pasi të ndodhë katastrofa, mundësisht në afat prej 14 ditëve pasi të keni filluar me zbatimin e aktiviteteve tuaja.

Çka duhet të bëjë shoqata nacionale që të marrë mjete financiare nëpërmjet Federatës ndërkombëtare në përgatitjet e veta për katastrofën e drejtpërdrejtë?

Lista për kontrollim A – Hapa kyçe për kërkimin e mjeteve financiare DREF për përgatitje në katastrofa apo krizë

Hapi 1: Kontaktoni përfaqësuesin e Federatës ndërkombëtare në vendin, rajonin apo zyrën zonale tuaj

Punë kyçe të cilat duhet të merren parasysh

- Siguroni informacione për situatën dhe si shoqata juaj nacionale planifikon të përgjigjet në katastrofa.
- Nëse ka mundësi, siguroni lonqe me internet faqe të caktuara nëpërmjet të cilës do të mund ta tregoni ndikimin në katastrofa.

Hapi 2: Kontrolloni se a mund të kërkoni alokacion DREF për atë se çka ndodh

Punë kyçe të cilat duhet të merren parasysh

- A ekziston mundësi e madhe se katastrofa do të ndodhë në disa ditët në vijim apo disa javë? Nëse përgjigja është e vërtetuar mund të kërkoni alokacion DREF.
- Mund të kërkoni alokacion DREF për llojet e katastrofave në vijim:
 - Sezonalë apo ngjarje tjera të cilat përsëriten, të cilat mund ta keqësojnë situatën se sa që është në situatë të zakonshme. Në këtë rast duhet të jenë të gatshëm ta tregoni nivelin e rritur të rrezikut.
 - Katastrofa e cila fillon menjëherë (si për shembull: cikloni, fortuna tropikale, përmbytjet, konfliktet qytetare lidhur me zgjedhjet etj.):
 - Katastrofa të cilat veprojnë ngadalë (si për shembull: epidemia (kolera), përmbytjet të cilat zhvillohen ngadalë, uria, thatësira etj.) nëse është plotësuar një nga kriteret në vijim:
 - Ekziston vëllim i rritur i nevojave akute.
 - Qeveria kërkon ndihmë ndërkombëtare.
 - Situata thërret në përgjigje emergjente që të plotësohen nevojat emergjente.
- Tek katastrofat të cilat ndodhin ngadalë e për të cilat ka nevojë për aksion emergjent shikoni në udhëzimin në Faza 2: menjëherë pasi të ndodhë katastrofa?

Hapi 3: Përgatitni plan inicial emergjent për aksion dhe buxhet

Gjëra të cilat duhet të merren parasysh

- Lista për kontrollim 1 për 5 hapa kyçe për përgatitje të planit emergjent

për aksion për katastrofë të drejtpërdrejtë dhe krizë i mbulon shumicën e pyetjeve të cilat duhet t'i përgjigjeni në bazë të arsytimit të kërkesës tuaj për sigurimin e mjeteve financiare.

- Në planin emergjent sqaroni se cilat aktivitete për momentin i ndërmerr shoqata juaj nacionale. Sqaroni se çka planifikoni të bëni para, gjatë dhe pas katastrofës.
- Numëroni aktivitetet të cilat do t'i zbatoni para katastrofës dhe/apo prej 2 deri 4 javë pasi të ndodhë katastrofa. Tregoni se sa do të zgjasë secili aktivitet dhe llogaritni sa të holla do të kushtojë secili aktivitet.
- Me siguri do të zbatoni aktivitete në kuadër të sektorëve teknik në vijim: paralajmërim i hershëm, përgatitshmëri për përgjigje emergjente, aktivitete për përgjigje në pyetje emergjente shëndetësore (ndihma e parë)? Sigurimi i strehimoreve gjatë situatave emergjente (për popullatë të evakuuar) apo sigurimin e ndihmës emergjente në ushqim.
- Diskutoni me përfaqësuesin e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.
- Diskutoni me përfaqësuesin e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe se çfarë ndihme teknike ju nevojitet nga Federata ndërkombëtare për të implementuar operacionin (ndihmë në sektorin specifik teknik, në zbatimin e vlerësimit të nevojave apo vlerësimin e tregut, për përgatitjen e planit emergjent në detaje për aksion, për furnizime dhe logjistikë, për implementimin e programe kesh transfer apo për monitoring, evaluim apo dorëzimin e raportit për operacionin).
- Në buxhetin tuaj për kërkimin DREF ju duhet:
 - Llogaritni se sa vullnetarë ju nevojiten dhe shpenzimet që nevojiten për: sigurim, pajisje dhe vizibiliteti, pajisje, shpenzime për rrugë dhe mëditje. Futni shpenzimet për rrugë, vendqëndrim, mëditje për të punësuarit e shoqatës nacionale të cilët janë të kyçur drejtpërsëdrejti në operacion.
 - Llogaritni se sa do të kushtojë transporti, depoja, dhe shpërndarja e ndihmës humanitare dhe monitoringu i shpërndarjes, apo implementimi i programit kesh transfer (taksa për transfere dhe shpenzime shpërndarëse).
 - Futni shpenzimet për përkrahjen operative (për resurse humane, logjistikë, komunikime, shpenzime për zyre apo taksa financiare). Këto janë shpenzime të cilat akumulohen me situatën emergjente dhe ato duhet të jenë me qëllim (nuk guxojnë të jenë më të larta se 40 përqind nga buxheti i përgjithshëm i operacionit përsigurimine ndihmës humanitare).
 - Në këtë fazë kyçni vetëm shpenzimet operative të cilat janë me rëndësi esenciale për të zbatuar aktivitetet gjatë ditëve apo javëve të para të operacionit.
- Mbani mend se buxheti mund të revidohet pasi të dihet vëllimi i përgjithshëm i katastrofës.

Hapi 4: Dorëzoeni kërkesën tuaj me apelin emergjent për aksion dhe buxhetin tek përfaqësuesi i Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Gjëra të cilat duhet të merren parasysh:

- Kur ka mundësi përdorni grafikone dhe tabela që t'i prezantoni informacionet (për shembull informacione për dëme dhe nevoja apo për numrin e familjeve të cilëve do t'ju ndihmoni, duke kyçur edhe informacione nga organizata tjera apo pushtete publike, nëse ka nevojë).
- Kyçni harta, detaje për lokacione apo fotografi.

Hapi 5: Përgatitni memorandum për bashkëpunim me Federatën ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe për marrjen e mjeteve financiare nga Fondi DREF

Aspekte kyçe të marrëveshjes:

- Shuma e cila duhet të transferohet nga ana e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.
- Personat zyrtarë në shoqatën nacionale dhe Sekretariatit e Federatës ndërkombëtare të cilat do ta udhëheqin operacionin.
- Të dhënat e patjetërsueshme për bërjen e Bank Of Transfer.
- Të dhëna për dorëzimin e raporteve.
- Data për dërgimin e raportit final financiar dhe narativ.
- Marrëveshje për kthimin e mjeteve financiare të përdorura në Fondin DREF.

Hapi 6: Vazhdoni aktivitetet tuaja deri sa të arrijnë mjetet financiare

Nëse ndodh katastrofa apo kriza përgatitni apo ripërtrini planin emergjent për aksion që t'i kyçni të gjitha aktivitetet e nevojshme për përgjigje dhe të kërkonti alokacion DREF, përderisa është patjetër apo apel emergjent (*shiko Pjesa 2 deri 4 javë pas katastrofës*).

Nëse katastrofa apo kriza nuk e ka ndikimin inicial të vlerësuar, përgatitni ripërtrirje të shkurtë të informacioneve me qëllim t'i informoni partnerët se nuk ka aksione plotësuese. Kaloni në fazën 6 dhe filloni me përgatitjen e raportit final.

Letërsi plotësuese:

Udhëzim për DREF: Federata ndërkombëtare. Procedurat dhe udhëzimet DREF. Gjenevë, 2011

https://fednet.ifrc.org/PageFiles/125112/031_e_v300_DREF%20Procedures%20and%20Guidelines.docx

Federata ndërkombëtare. Plan emergjent për aksion – format për planifikim operativ (operacioni DREF)

Federata ndërkombëtare DREF

<https://fednet.ifrc.org/en/resources/disasters/disaster-and-crisismangement/disaster-response/dref/>

Udhëzim për mekanizma për përgatitjen e apelit emergjent: Federata ndërkombëtare. Procedura dhe udhëzim për apel emergjent. Gjenevë, 2013

<https://fednet.ifrc.org/en/resources/disasters/disaster-and-crisis-mangement/disaster-response/peas-eas-updates/>

federata ndërkombëtare. Format për plan emergjent për aksion.

<https://fednet.ifrc.org/en/resources/disasters/disaster-and-crisis-mangement/disaster-response/emergency-plan-of-action-epoa/>

Udhëzim për planifikim monitoring dhe evaluim: Federata ndërkombëtare. Doracak për planifikim të projekteve / programeve. Gjenevë, 2010.

www.ifrc.org/Global/Publications/monitoring/PPP-Guidance-Manual-English.pdf

Kkornizë për monitoring dhe evaluim (Federata ndërkombëtare dhe DREF).

<https://fednet.ifrc.org/en/resources/disasters/disaster-and-crisis-mangement/learning-evaluation/monitoring--evaluating-framework/>

Faza 2:

Menjëherë pas katastrofës

Menjëherë pas katastrofës vëmendja juaj do të drejtohet në vlerësimin e ndikimit të katastrofës në vendin tuaj të popullatës në vendet e goditura si dhe në menaxhimin e aktiviteteve për shpëtimin e jetëve.


Në të gjitha aspektet për përgjigje në situatë emergjente, qëllimi duhet t'i jetë shpëtimi dhe mirëmbajtja e jetës së njerëzve dhe promovimi i aktiviteteve për rimëkëmbjen e popullatës së goditur.

Implementimi i aktiviteteve për përgjigje në situatë emergjente duhet të jenë të përbëra prej:

- Aktivizimi i planit emergjent për aksion
- Mobilizimi dhe pajisja e vullnetarëve
- Kërkim dhe shpëtim
- Evakuim i popullatës së goditur
- Bashkimi i lidhjeve familjare
- Ndihma e parë
- Shpërndarja e ndihmës humanitare (në natyrë dhe ndihmë financiare)
- Trajnim të vullnetarëve
- Identifikimi dhe mobilizimi i ekspertizës teknike
- Përgatitja e planit emergjent fillestar për aksion

Hapa kyçe për përgatitjen e planit emergjent për aksion

Hapat kryesore për ndërmarrjen e vlerësimit fillestar, analizës dhe planifikimit do të përbëhen prej:



Këto 5 hapa ju çojnë kah sigurimi i informacioneve të patjetërsueshme për planin emergjent inicial për aksion, i cili do të shërbejë si bazë për menaxhimin e operacionit.

Ky plan emergjent inicial për aksion gjithashtu do t'ju mundësojë që partnerët tuaj të jenë të njoftuar me aktivitetet e juaja të planifikuara dhe mobilizimin e fondeve, nëse ka nevojë.

Më poshtë do të gjeni listën e kontrollimit e cila jep më shumë detaje në bazë të secilit prej këtyre 5 hapave.

Kur nuk ka informacione të kapshme të japin përgjigje në njërin prej pyetjeve të parashtruara në listën për kontrollim, rekomandohet të shihet se sa ai aktivitet është i rëndësishëm për fillimin e aktiviteteve për përgjigje gjatë katastrofave.

Lista për kontrollim 2.- Pesë hapa kyçe për përgatitjen e planit emergjent për aksion për katastrofë apo krizë të drejtpërdrejtë.

Hapi 1: Vlerësimi i ndikimeve të mundshme dhe dëme nga katastrofa	
<p>Pyetje të cilat duhet të merren parasysh</p> <ul style="list-style-type: none"> • Çka mund të ndodhë? Kur? • Cilat pjesë me siguri do të goditen? • Sa njerëz mund të jenë të goditur nga katastrofa? • Çfarë ndikimi pritet se do të ketë rreziku në vendin tuaj? Çfarë dëmi do të shkaktojë dhe çfarë pasoja të mundshme mund të dalin? 	<p>Aktivitetet për përkrahje</p> <ul style="list-style-type: none"> • Monitoring dhe evolucion i situatës • Vëzhgimi i tregut dhe çmimeve • Përcjellja e informacioneve nga vepruesit tjerë
Humbja e jetës	Shpërmgulja e popullatës. Anëtarë të ndarë të familjeve të ndara
Lëndim	Humbja apo dëmi i ndërtesave dhe infrastrukturës publike
Humbja e qasjes në ushqim dhe ujë	Shkatërrim / çrregullim i shërbimeve esenciale
Humbja e bagëtisë	Humbja apo dëmtimi i tregjeve lokale
Humbja apo dëmtimi i kullosave dhe mjedisit jetësor	Rrezik i rritur nga sëmundjet dhe implekimet tjera shëndetësore
Shkatërrim apo dëme të shtëpive	
<ul style="list-style-type: none"> • Si mundet situata të zhvillohet në javët apo muajt vijues? A ka efekte sekondare që priten siç janë traumat vijuese, lëvizja e popullatës apo rreziku nga paraqitja e sëmundjeve të cilat barten me ujin? 	

Hapi 2: Vlerësimi i nevojave potenciale dhe situatave të mjeruara

<p>Pyetje të cilat duhet të merren parasysh</p> <ul style="list-style-type: none">• Cilat janë kërcënimet emergjente për mirëqenien e njerëzve?• Cilat janë nevojat emergjente?• Cila popullatë është më e mjeruar / më e goditur? Pse kjo popullatë është më e mjeruar se sa popullata tjetër (shembull: mosha, gjinia, hendikepi, prindërit që kujdesen vetë, grupi minor etj.)?• A ka nevojë për aksion emergjent?	<p>Aktivitete për përkrahje</p> <ul style="list-style-type: none">• Konsultime me organizatat komunale të Kryqit të kuq, pushtetet lokale dhe vepruesit tjerë.
--	--

Hapi 3: Analiza e kapaciteteve

<p>Pyetje të cilat duhet të merren parasysh</p> <ul style="list-style-type: none">• Si është kapaciteti për përgjigje e shoqatës nacionale?<ul style="list-style-type: none">○ A keni organizata komunale të Kryqit të kuq / vullnetarë në fushat për të cilat ekziston mundësi se do të goditen? A jeni në gjendje të kontaktoni me ato? Çfarë kapacitete posedojnë ato? Çfarë hapa kanë ndërmarrë ata?○ A keni plan për aksion emergjent për këtë situatë emergjente? Nëse keni, a e keni aktivizuar ?○ A keni rezerva të mallërave për përdorim në rast të përgatitshmërisë për katastrofën?<ul style="list-style-type: none">▪ Po – A janë të mjaftueshme për të plotësuar nevojat emergjente?▪ Po – A i keni pozicionuar në pjesët të cilat janë në afërsi të lokacionit të mundshëm ku do të ndodhë katastrofa.▪ Jo – Ku mund të sigurohen sasi të nevojshme për ndihmë (në natyrë / mjete financiare)? Në nivel lokal apo nga rezervat e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe?	<p>Aktivitete për përkrahje</p> <ul style="list-style-type: none">• Ndarja e informacioneve dhe koordinim me partnerë mes cilave KNKK dhe partnerë tjerë të lëvizjes.• Postimi i raportit në sistemin informativ për menaxhim me katastrofa.
---	---

